

3. Misioni dhe objektivi:

3.1 Misioni i QSU “Nene Tereza” është:

- Të ofrojë shërbimin mjekësor me përkushtim, profesionalizëm dhe cilësi të lartë, duke vënë në dispozicion të të sëmurëve maksimumin e kapaciteteve njerëzore, dijeve dhe faciliteteve që disponon;
- Të japë ndihmë mjekësore të specializuar (terciare) për gjithë banoret e vendit dhe shërbim mjekësor dytësor për banoret e Tiranës, duke shërbyer me profesionalizëm sipas rregullave të deontologjisë dhe të etikës mjekësore si dhe duke ruajtur sekretin profesional dhe informacionin e pacientëve;
- Të trajtojë dhe t’u shërbejë të sëmurëve, sipas gjendjes dhe nevojave psikologjike dhe fizike, me standartin më të lartë deontologjik, duke respektuar dinjitetin dhe personalitetin e të sëmurëve, si dhe duke ruajtur sekretin profesional dhe privatësinë e pacientëve;
- Të shërbejë si bazë pedagogjike për formimin e studentëve të Mjekësisë, formimin e vazhdueshëm të mjekëve dhe specializantëve.
- Të shërbejë si bazë kërkimore–shkencore në fushën e shëndetësisë, në bashkëpunim me Universitetin e Mjekësisë Tiranës dhe struktura të tjera kërkimore shkencore.

3.2 Objektivi i QSU “Nënë Tereza”, është që nëpërmjet administrimit efektiv dhe eficient të burimeve, shfrytëzimit të mekanizmave të përmirësuar të financimit, zhvillimit të standardeve, rritjes së kapaciteteve e kompetencave, futjes së teknikave e praktikave të reja diagnostikuese e mjekuese, të realizojë trajtim mjekësor cilësor dhe konkurrues, të rrisë përkujdesin ndaj të sëmurëve dhe trajtimin me sukses të sëmundjeve të tyre, si dhe të konsolidojë statusin e një qendre prioritare kompetence dhe ekselence në fushën e shkencave mjekësore.